

SHTOJCA 1**Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

Emri i kompanisë	Elektro System SH.P.K.
Lloji i veprimtarisë	Parku solar fotovoltaik me kapacitet të instaluar 0.57 MW (570 kWp)
Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	ZK Prekallë, Komuna e Istogut
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë	Bashkim Osmanaj
Adresa	Rr. Adem Jashari, Pejë
Telefoni , fax, e-mail	044 257 238 elektrosystem16@gmail.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Bashkim Osmanaj
Adresa	Rr. Adem Jashari, Pejë
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	• Certifikata e biznesit - NUI: 810750100, e datës 18.04.2016; • Vendimi për Pëlqimin Mjedisor - Nr. 6336-2/25, i datës 03.12.2025; • Leja Ndërtimore - Nr. 11-351-45958/158, e datës 30.12.2025; • Pëlqimi Elektroenergjetik i KEDS-it - Nr. 5723, i datës 22.04.2026; • Vendimi për lëshimin e autorizimit nga ZRRE - Nr. 657/26, i datës 24.07.2026 (Kodi: V_3294_2026); • Dokumentet e tjera relevante për realizimin dhe operimin e aktivitetit.
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	249,715.00 euro
Fatura e pagesës së tarifës për leje mjedisore	Po
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në pesë (1) kopje fizike dhe një (1) kopje elektronike (CD).	Po

Shtojca 2

Aplikacion për dhënie e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME		
Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	Elektro System SH.P.K.
	Vendi	Pejë
	Adresa	Rr. Adem Jashari, Pejë
	Nr. i tel./fax	044 257 238
	E-mail	elektrosystem16@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	NUI: 810750100; data e regjistrimit: 18.04.2016
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Bashkim Osmanaj
	Nr. i tel./fax	044 257 238
	E-mail	
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Bashkim Osmanaj
	Nr. i tel./fax	044 257 238
	E-mail	elektrosystem16@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	PARKU SOLAR FOTOVOLTAIK 0.57 MW (570 kWp)
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	ZK PREKALLË, KOMUNA E ISTOGUT

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Parku solar fotovoltaik ndodhet në Zonën Kadastrale Prekallë, Komuna e Istogut, në ngastrat kadastrale P-70806039-00371-6 dhe P-70806039-00371-7. Dokumentacioni është përgatitur për shoqërinë “Elektro System” SH.P.K., me seli në Pejë.    Lokacioni është përzgjedhur në bazë të kushteve të terrenit, ekspozimit ndaj rrezatimit diellor, qasjes infrastrukture dhe përputhshmërisë me dokumentacionin urbanistik, mjedisor dhe elektroenergjetik të projektit.
2.2	Numri kadastral i parcelës	ZK Prekallë, Komuna e Istogut; ngastrat kadastrale P-70806039-00371-6 dhe P-70806039-00371-7.
2.3	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Në zonën e projektit dhe në rrethinën e saj gjenden kryesisht toka bujqësore, objekte banimi dhe disa objekte të veprimtarive ekonomike. Objektet e banimit ndodhen në një distancë rreth 190 m, ndërsa varrezat e fshatit rreth 100 m nga kufiri i parcelës. Panelet janë vendosur me tërheqje rreth 5 m nga kufiri i parcelës, duke krijuar distancë shtesë sigurie dhe hapësirë për mirëmbajtje.


		 Gjatë operimit të parkut solar nuk priten ndikime të rëndësishme negative në popullatë. Aktiviteti nuk gjeneron emetime industriale në ajër ose ujëra të ndotura dhe kërkon vetëm vizita të herëpashershme për kontroll dhe mirëmbajtje. Zona përreth karakterizohet me toka bujqësore ku kultivohen kultura të zakonshme sezonale.
2.4	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Flora dhe fauna Bazuar në vërtetimet vizuale dhe karakteristikat e përdorimit të tokës, bimësia në lokacion përfaqësohet kryesisht nga bimë të ulëta barishtore, kultura periodike bujqësore dhe bimësi drusore e shpërndarë. Në rrethinën më të gjerë hasen plepi, bagremi, bungi, kaçë, murrizi, mana dhe manaferra. Fauna e zonës lidhet me habitatet bujqësore dhe rurale. Mund të hasen insekte, lepuri i egër, dhelpra, iriqi dhe shpendë të zakonshëm të fushave dhe vendbanimeve. Operimi i parkut solar, me kusht zbatimin e masave të menaxhimit, nuk pritet të shkaktojë ndikime të rëndësishme në këto lloje. Gjatë mirëmbajtjes duhet të shmangët dëmtimi i panevojshëm i vegjetacionit dhe shqetësimi i faunës, veçanërisht gjatë periudhave të shumimit të shpendëve.
2.5	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Sipas dokumentacionit në dispozicion, lokacioni i projektit nuk shtrihet brenda një zone të veçantë të mbrojtur dhe nuk evidentohet ndërhyrje në zona arkeologjike ose në trashëgimi kulturore. Në rast të zbulimeve të rastësishme gjatë punimeve të mirëmbajtjes, punimet duhet të ndërpriten dhe të njoftohet institucioni kompetent.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrimi i aktivitetit për të cilin kërkohet leja mjedisore

3.1.1

Skema e procesit teknologjik



Skema e procesit teknologjik të parkut solar 0.57 MWp

○ Parimi i punës

Parimi i punës së sistemit fotovoltaike bazohet në shndërrimin e rrezatimit diellor në energji elektrike. Prodhimi varet nga rrezatimi diellor, orientimi dhe këndi i moduleve, temperatura e moduleve, humbjet elektrike dhe efikasiteti i pajisjeve të sistemit.

Parametrat teknikë kryesorë të parkut solar fotovoltaike

Parku solar ka kapacitet të autorizuar prej 0.57 MW. Kapaciteti DC i instaluar është 569.74 kWp, i rrumbullakosur në 570 kWp, dhe realizohet me 934 module fotovoltaike me fuqi nominale 610 Wp secili, të montuara mbi konstruksione metalike të galvanizuara.

Energjia elektrike e prodhuar nga modulet përcillet përmes kabllave DC deri te inverterët, ku shndërrohet nga rrymë e drejtë (DC) në rrymë alternative (AC). Më pas, energjia transmetohet përmes kabllave AC drejt trafostacionit dhe pikës së lidhjes me rrjetin elektroenergetik.

Centrali është i pajisur me sistem monitorimi dhe kontrolli, tokëzim, mbrojtje elektrike, rufepritës, pajisje për ndërprerje automatike dhe elemente të tjera të sigurisë, në përputhje me projektin elektrik dhe kushtet e lidhjes të

3.1.2

Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik

përcaktuara nga KEDS-i.

Perimetri i parkut solar është i rrethuar me gardh mbrojtës për të kufizuar qasjen e personave të paautorizuar dhe për të mbrojtur instalimet.


Këndi i pjerrtësisë dhe orientimi i moduleve fotovoltaike

Modulet janë vendosur me orientim jugor dhe me kënd pjerrtësie 18° , sipas konfigurimit të projektit. Ky konfigurim synon optimizimin e prodhimit vjetor dhe zvogëlimin e humbjeve nga hijezimi.

Distanca ndërmjet rreshtave është përcaktuar duke marrë parasysh dimensionet e moduleve, lartësinë nga toka, këndin e pjerrtësisë dhe pozicionin e diellit gjatë periudhës dimërore.


Konfigurimi i rreshtave mundëson qasje për kontroll, pastrim dhe mirëmbajtje, si dhe rrjedhje natyrore të ujërave atmosferike.

Vendosja e moduleve dhe konstruksioneve është realizuar në mënyrë që, pas përfundimit të jetës operative, pajisjet të mund të çmontohen dhe lokacioni të rehabilitohet.



Konfigurimi fizik i vargut (array)


Parametrat kryesorë gjeometrikë për paragjatjen e vargjeve fotovoltaike përfshijnë hapësirën ndërmjet rreshtave d , lartësinë e hapësirës nga toka H dhe këndin vertikal midis sipërfaqes horizontale dhe sipërfaqes së modulit β (këndi i pjerrtësisë) të shprehur në gradë $^{\circ}$, siç tregohet në figurën më poshtë.



Për përcaktimin e largësisë ndërmjet rreshtave janë marrë parasysh hijezimi, këndi i diellit në solsticin dimëror dhe kërkesa që prodhimi të mos kufizohet në mënyrë të panevojshme nga hijet e rreshtave fqinj.

Grafiku i rrugës së diellit paraqet në mënyrë orientuese ndryshimin e lartësisë dhe azimutit të diellit për lokacionin e projektit në ZK Prekallë.

Vlerat përfundimtare të distancës ndërmjet rreshtave dhe të lartësisë së konstruksioneve zbatohen sipas projektit teknik të ekzekutuar.



PVSvst/PVGIS.

Grafiku orientues i rrugës së diellit për lokacionin e projektit - ZK Prekallë

Strukturat metalike

Strukturat metalike janë të prodhuesit Turk - Isotec (Turqi) dhe posedojnë të gjitha certifikatat EC dhe kanë garancion të reciklimit.




Figura 17 Strukturat metalike të propozuara për projektin solar



Përzgjedhja e inverterëve

Inverterët përzgjidhen sipas projektit elektrik të ekzekutuar dhe duhet të jenë të përputhshëm me kapacitetin DC të instaluar prej 569.74 kWp (rreth 0.57 MWp).

Kriteri	Kërkesa teknike
Kapaciteti i sistemit	0.57 MWp (570 kWp)
Tensioni maksimal DC	Brenda kufirit të lejuar nga prodhuesi
Gama e punës MPPT	E përputhshme me tensionin e vargjeve FV
Rryma hyrëse	Brenda rrymës maksimale për hyrje/MPPT
Fuqia totale AC	Sipas skemës njëpolare dhe kushteve të lidhjes
Mbrojtjet	Anti-islanding, mbritension/nëntension, qark i shkurtër, surge
Monitorimi	Komunikim me sistemin e monitorimit/SCADA
Standardet	Përputhshmëri me standardet IEC/EN dhe kërkesat e rjetit

Figura - Kriteret teknike për përzgjedhjen e inverterëve

Konfigurimi i vargjeve fotovoltaike

Konfigurimi i vargjeve fotovoltaike dhe përzgjedhja e inverterëve bëhen në përputhje me tensionin, rrymën dhe fuqinë e moduleve, kufijtë MPPT të inverterëve dhe kushtet e temperaturës e rrezatimit.

Tensioni maksimal i vargut, tensioni minimal në pikën e fuqisë maksimale dhe rrymat hyrëse duhet të mbeten brenda kufijve të përcaktuar në dokumentacionin teknik të pajisjeve.

Procedura e përcaktimit të konfigurimit

Konfigurimi teknik përfshin këto hapa:

- përcaktimin e tensioneve VOC dhe VMPP të moduleve;
- përzgjedhjen e inverterëve sipas projektit elektrik;
- përcaktimin e numrit të moduleve në secilin varg dhe numrit të vargjeve;
- verifikimin e raportit DC/AC dhe të mbrojtjeve elektrike;

Konfigurimi përfundimtar

Konfigurimi përfundimtar i vargjeve dhe inverterëve zbatohet sipas projektit elektrik të ekzekutuar dhe dokumentacionit të prodhuesve. Kapaciteti

		total DC i instaluar mbetet 569.74 kWp, përkatësisht rreth 0.57 MWp. Numri i moduleve, vargjeve dhe hyrjeve MPPT duhet të përputhet me skemën njëpolare dhe tabelat e projektit elektrik. Raporti DC/AC dhe parametrat e mbrojtjes verifikohen gjatë komisionimit dhe monitorohen gjatë operimit.  Vlerësimi i prodhimit të energjisë Rrezatimi diellor Të dhënat e rrezatimit diellor janë bazë për vlerësimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe për analizën e performancës së sistemit fotovoltaiik. Vlerësimi i prodhimit mund të kryhet me programe profesionale, si PVsyst, duke përdorur të dhëna klimatike dhe rrezatimi nga burime të njohura. Rezultatet duhet të paraqesin prodhimin mujor dhe vjetor për kapacitetin e instaluar 0.57 MWp në lokacionin e “Elektro System” SH.P.K., ZK Prekallë.
3.1.3	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Parku solar operon automatikisht gjatë orëve me rrezatim diellor, shtatë ditë në javë. Kontrolli dhe mirëmbajtja kryhen periodikisht ose sipas nevojës, pa proces të vazhdueshëm pune nga personeli në lokacion.
3.1.4	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti i projektuar dhe i realizuar është 0.57 MWp (570 kWp). Prodhimi vjetor orientues, bazuar në koeficientët e përdorur në dokumentin bazë, është rreth 695.41 MWh.

		për Rrugët, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-120. • Ligji Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. • Udhëzimi Administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trupat ujorë dhe në rrjetin e kanalizimit publik. • Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025.
--	--	--

3.2. MENAXHIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT		
3.2.1	Sistemi i menaxhimit të mbrojtjes së mjedisit	Operimi i parkut solar menaxhohet përmes sistemit të automatizuar të monitorimit dhe nga personeli i autorizuar i kompanisë. Sistemi përfshin monitorimin e moduleve fotovoltaike, inverterëve DC/AC, trafostacionit, pajisjeve mbrojtëse, sistemit të tokëzimit dhe parametrave të prodhimit. Personeli përgjegjës kryen kontrole periodike, evidenton avaritë, organizon mirëmbajtjen dhe siguron menaxhimin e rregullt të mbeturinave. Gjatë operimit nuk parashihen emetime industriale në ajër, shkarkime teknologjike në ujë ose shkarkime në tokë. Ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me vizitat e mirëmbajtjes dhe me menaxhimin e pajisjeve të dëmtuara.
3.2.2	Raportimi	Raportimi kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti. Raportet dhe evidencat përfshijnë mirëmbajtjen, avaritë, mbeturinat dhe parametrat e monitorimit të kërkuar me Pëlqimin Mjedisor dhe Lejen Mjedisore të lëshuar nga MMPHI-ja.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Gjatë operimit të parkut solar nuk ka burime stacionare të emisioneve në ajër. Emetime të rralla dhe afatshkurtra mund të shkaktohen vetëm nga automjetet që përdoren për inspektim dhe mirëmbajtje. Ndotësit potencialë lidhen me gazrat e shkarkimit të automjeteve dhe me pluhurin nga qarkullimi në rrugë të paasfaltuara.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Për shkak të frekuencës së ulët të qarkullimit dhe mungesës së proceseve të djegies, ndikimi në cilësinë e ajrit vlerësohet i vogël, lokal dhe i përkohshëm.
4.3	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive kufizohen në ngritjen e përkohshme të pluhurit nga automjetet e mirëmbajtjes dhe nga aktivitetet e rralla të pastrimit ose riparimit.
4.4	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk nevojiten pajisje për trajtimin e gazrave shkarkuese, sepse impianti nuk ka burime stacionare të gazrave.
4.5	Pajisjet për de-pluhurin	Nuk nevojiten pajisje për de-pluhurosje. Në raste të thata, pluhuri nga qarkullimi kontrollohet me kufizim të shpejtësisë dhe, sipas nevojës, me lagje të sipërfaqeve.
4.6	Monitorimi i emisioneve	Nuk parashihet monitorim periodik instrumental i emisioneve, për shkak të mungesës së burimeve stacionare. Kontrolli kryhet përmes inspektimeve vizuale dhe evidencimit të aktiviteteve të mirëmbajtjes.
4.7	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit	Matjet e cilësisë së ajrit do të realizohen nëse kërkohen nga autoriteti kompetent ose në rast të ankesave të arsyetuara.
4.8	Raportimet	Të dhënat për aktivitetet që mund të ndikojnë në ajër përfshihen në raportimin mjedisor, sipas kushteve të lejes.

4.9	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Masat kryesore janë: • kufizimi i shpejtësisë së automjeteve në 30 km/orë në zonat e banuara dhe në rrugët e brendshme; • mirëmbajtja e rregullt e automjeteve dhe pajisjeve; • shmangia e punës së panevojshme të motorëve në vend; • pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirës së impiantit; • lagia e sipërfaqeve të pluhurosura, kur është e nevojshme.
4.10	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Prodhimi i energjisë nga burimi diellor kontribuon në zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë krahasuar me prodhimin nga lëndët djegëse fosile. Përfitimi klimatik varet nga energjia vjetore e prodhuar dhe nga energjia që zëvendësohet në sistemin elektroenergetik. Operatori do të mirëmbajë pajisjet për të ruajtur efikasitetin dhe jetëgjatësinë e sistemit.

5. UJI

5.1	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Gjatë operimit nuk përdoret ujë për procese industriale. Sasi të kufizuara mund të përdoren vetëm për pastrimin periodik të moduleve, kur kërkohet.
5.2	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Nuk ka shkarkime të ujërave teknologjike ose sanitare nga impianti. Ujërat atmosferike rrjedhin natyrshëm në terren, pa u përzier me substanca ndotëse.
5.3	Ndikimet në ujë	Nuk priten ndikime të rëndësishme në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore. Rreziku lidhet vetëm me derdhje aksidentale nga automjetet e mirëmbajtjes, të cilat duhet të parandalohen dhe të sanohen menjëherë.
5.4	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve	N/A

	kryesor	
5.5	Trajtimi i ujërave të ndotura	N/A
5.6	Kontrolli dhe matjet	N/A
5.7	Raportimi	N/A
5.8	Leje ujorë për shfrytëzim të ujit	N/A
5.9	Leje ujorë shkarkimin e ujërave	N/A
5.10	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Servisimi i automjeteve dhe ndërrimi i vajrave nuk lejohen në zonën e paneleve. Materialet absorbuese duhet të jenë në dispozicion për raste të derdhjeve aksidentale. Të gjitha mbeturinat e mirëmbajtjes largohen nga lokacioni dhe dorëzohen te operatorët e autorizuar.

6. ZHURMA		
6.1	Burimet	Burimet e zhurmës gjatë operimit janë inverterët, transformatori dhe automjetet e mirëmbajtjes. Zhurma e pajisjeve është e vazhdueshme por e nivelit të ulët dhe kufizohet në afërsi të pajisjeve; qarkullimi i automjeteve është i rrallë dhe i përkohshëm.
6.2	Kontrolli dhe matjet	Kontrolli kryhet përmes mirëmbajtjes së pajisjeve dhe inspektimeve periodike. Matje të zhurmës realizohen në rast të ankesave, ndryshimit të pajisjeve ose kërkesës së autoritetit kompetent.
6.3	Raportimet	Rezultatet e matjeve eventuale dhe ankesat e pranura evidentohen dhe raportohen sipas kushteve të lejes mjedisore.

7. TOKA		
7.1	Ndikimet në tokë	Gjatë operimit, ndikimet në tokë janë të kufizuara në sipërfaqet e zëna nga konstruksionet, kabllot dhe pajisjet elektrike. Rreziku kryesor paraqitet nga menaxhimi jo i duhur i mbeturinave ose nga derdhjet aksidentale gjatë mirëmbajtjes.
7.2	Masat për zvogëlimin e	Masat për mbrojtjen e tokës përfshijnë: • ndalimin e servisimit dhe të ndërrimit të vajrave në lokacion;

	ndikimeve në tokë	• grumbullimin e mbeturinave në enë të përshtatshme dhe largimin e tyre nga operatorë të autorizuar; • përdorimin e materialeve absorbuese në rast derdhjeje; • ruajtjen e mbulesës bimore ndërmjet rreshtave dhe kontrollin e erozionit.
7.3	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të aktivitetit, modulet, inverterët, kabllo, trafostacioni dhe konstruksionet metalike çmontohen dhe largohen për ripërdorim, riciklim ose trajtim të autorizuar. Elementet e betonit, nëse ka, largohen dhe trajtohen si mbetje inerte. Terreni nivelizohet, plotësohet me shtresë pjellore sipas nevojës dhe revegjetohet me lloje të përshtatshme, në përputhje me destinimin e ardhshëm të tokës dhe kërkesat e autoriteteve kompetente.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
8.1	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Gjatë operimit gjenerohen sasi të vogla të mbeturinave komunale nga personeli i mirëmbajtjes. Në raste të rralla mund të gjenerohen ambalazhe, kablo, pajisje elektrike/elektronike, inverterë ose module fotovoltaike të dëmtuara. Këto mbetje klasifikohen dhe menaxhohen sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave.
8.2	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Mbeturinat komunale ruhen në kontejner të mbyllur. Mbetjet elektrike dhe elektronike ruhen përkohësisht në vend të sigurt, të mbrojtur nga reshjet dhe të shënuar, pa u përzier me mbeturinat komunale.
8.3	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Mbetjet e riciklueshme ndahen sipas llojit. Modulet dhe pajisjet e dëmtuara nuk çmontohen ose trajtohen në lokacion, por dorëzohen për ripërdorim, riciklim ose trajtim të operatorët e licencuar.
8.4	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje	Mbeturinat dorëzohen të operatorët që posedojnë lejet përkatëse. Kontratat, fletëdorëzimet dhe dëshmitë e pranimit ruhen në evidencën e kompanisë.

	përkatëse	
8.5	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Plani i menaxhimit përfshin parandalimin e gjenerimit, ndarjen në burim, magazinimin e sigurt, dorëzimin te operatorët e autorizuar dhe mbajtjen e evidencës për sasinë dhe destinacionin e mbeturinave.
8.6	Raportimi	Raportimi dhe evidencimi kryhen sipas legjislacionit për mbeturina dhe kushteve të lejes mjedisore.

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Rreziqet kryesore janë goditja elektrike, qarku i shkurtër, zjarri, rrufeja, dëmtimet nga erërat e forta dhe qasja e paautorizuar. Në rast incidenti, sistemi izolohet nga rrjeti, ndalohet qasja në zonën e rrezikut, njoftohet personeli përgjegjës dhe, sipas nevojës, shërbimet emergjente.
9.2	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Në operim normal nuk përdoren substanca të rrezikshme kimike. Vajrat ose lëngjet e pajisjeve elektrike, nëse janë të pranishme sipas specifikimeve të prodhuesit, menaxhohen në pajisje të mbyllura dhe kontrollohen për rrjedhje.
9.3	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Masat parandaluese përfshijnë: - kontrollin teknik dhe mirëmbajtjen periodike; - sistemet e tokëzimit, rrufepritësit dhe mbrojtjet elektrike; - ndërprerjen automatike në rast anomalie; - rrethimin, sinjalizimin dhe kufizimin e qasjes; pajisjet për fikjen fillestare të zjarrit dhe trajnimin e personelit.
9.4	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Gjendja e sigurisë dokumentohet përmes evidencave të kontrolleve, mirëmbajtjes, defekteve dhe incidenteve. Çdo incident me ndikim mjedisor raportohet te autoritetet kompetente sipas kërkesave ligjore.
9.5	Plani për mbrojtjen nga	Në lokacion vendosen aparate të përshtatshme kundër zjarrit,

	zjarri	shenja paralajmëruese dhe udhëzime për ndërprerjen e energjisë. Personeli duhet të njohë procedurën e reagimit dhe numrat e shërbimeve emergjente. Në rast zjarri në pajisje elektrike nuk përdoret ujë pa u bërë izolimi i sigurt i energjisë.
--	--------	---

10. MASAT NË RASTET E PUNËS JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Në rast të anomalive, mbrojtjet elektrike dhe sistemi i monitorimit mundësojnë ndërprerjen automatike ose manuale të pjesës së prekur. Pajisja izolohet, kontrollohet nga personi i autorizuar dhe rikthehet në punë vetëm pas eliminimit të shkakut.
10.2	Ndërprerja e punës	Ndërprerja e plotë e punës realizohet në raste të rrezikut për njerëzit, pajisjet ose mjedisin, gjatë mirëmbajtjes së planifikuar, me kërkesë të operatorit të rrjetit ose me urdhër të autoritetit kompetent.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM NË SHËNDETIN E NJERIUT
Gjatë operimit normal, parku solar nuk gjeneron emetime të gazrave, pluhur industrial, ujëra teknologjike ose zhurmë të lartë. Për këtë arsye, ndikimi në shëndetin e popullatës përreth vlerësohet i ulët. Rreziqet kryesore për personelin lidhen me energjinë elektrike, punën pranë pajisjeve nën tension, zjarrin, rrëshqitjen/rënien dhe ndërhyrjet e paautorizuara. Këto rreziqe kontrollohen përmes rrethimit, sinjalizimit, tokëzimit, mbrojtjeve elektrike, pajisjeve personale mbrojtëse dhe procedurave të punës së sigurt. Fushat elektromagnetike kufizohen kryesisht në afërsi të inverterëve, kablllove dhe trafostacionit. Qasja në këto zona lejohet vetëm për personelin e autorizuar dhe pajisjet duhet të mirëmbahen sipas standardeve teknike. Me zbatimin e masave të parashikuara, nuk priten ndikime të rëndësishme negative në shëndetin e njeriut.

Personi përgjegjës për mjedis
Emri dhe mbiemri: Bashkim Osmanaj

Personi përgjegjës i kompanisë
Emri dhe mbiemri: Bashkim Osmanaj

Nënshkrimi

Nënshkrimi
